



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË**  
**DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr.2135/7 Prot.

Tiranë, më 11.12.2024

**VENDIM**

**Nr. 39, datë 11.12.2024**

**PËR KONTROLLUESIN SHKOLLA JOPUBLIKE “ERNEST KOLIQI”**

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Shkolla Jopublike “Ernest Koliqi” (në vijim “Kontrolluesi”),

**KONSTATOVA SE:**

Në zbatim të Urdhrit nr. 159 datë 01.10.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- Verifikimi i zbatimit të detyrimeve sipas Rekomandimit Nr.6, datë 07.05.2024 (në vijim “Rekomandimi”) të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave personale për Kontrolluesin Shkolla Jopublike “Ernest Koliqi”.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NUIS L11730003C dhe ushtron aktivitetin si institucion arsimor parauniversitar privat në ciklin e ulët, 9-vjeçar dhe të mesëm, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Urdhrit nr. 31, datë 28.01.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për

miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

Në kuadër të veprimtarisë që kryen, Kontrolluesi përpunon të dhëna personale për kategoritë: “nxënës”, “punonjës”, “staf akademik”, “vizitorë”. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Kontrolluesi nuk ka përmbushur pikën 2 të dispozitivit të Rekomandimit, për të dhënat që mbledh për prindërit ose persona të tjerë përgjegjës lidhur me profesionin, vendin e punës, si dhe informacion mbi vendbanimin dhe gjendjen familjare nëpërmjet dokumentin që aplikon “*Formular regjistrimi*”, në kundërshtim kjo me parimin e mjaftueshmërisë, sipas germës “c”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, kategoritë e të dhënave të mbledhura/ruajtura, duhet të jenë në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim, si dhe mbajten në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej.

3. Në pikën 3 të dispozitivit të Rekomandimit është lënë si detyrë që Kontrolluesi të informojë subjektet e të dhënave kur mbledh të dhëna personale në “Formularin e Regjistrimit”, si dhe të informojë subjektet e të dhënave nëpërmjet në faqen e internetit nëpërmjet “*Politikave të Privatësisë*”.

Rezulton se, gjatë aplikimit të formularit të regjistrimit informimi nga Kontrolluesi përkundrejt subjekteve të të dhënave nuk është shterues në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Gjithashtu, Kontrolluesi ka publikuar “*Politikat e Privatësisë*” në faqen e internetit <https://ernestkoliqi.com/>, megjithatë nga analizmi i saj rezulton se subjekteve të të dhënave nuk informohen qartësisht për fushën dhe qëllimin për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, kategoritë e të dhënave personale, mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t’i përpunojë të dhënat, afatin e mbajtjes së të dhënave, masat e sigurisë, të drejtat që subjektet e të dhënave gëzojnë (akses, korrigjim dhe fshirje) etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale është i rëndësishëm, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të

njihen me të drejtat që gëzojnë, si dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga Kontrolluesi mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave. Informimi sipas përcaktimeve të nenit 18 të Ligjit, duhet të aplikohet për çdo proces përpunimi të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, që kryen Kontrolluesi.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ka detyrim që të publikojë “Politikën e Privatësisë” dhe të të informojë qartësisht subjektet e të dhënave, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes së internetit.

4. Kontrolluesi nuk ka përmbushur pikën 3 të dispozitivit të Rekomandimit për informimin e subjekteve të të dhënave mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejitimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejitimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejitimit, të miratuar nga Komisioneri.

Gjithashtu, lidhur me këtë proces përpunues, Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla apo politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi duhet të parashikoj rregulla/politika dhe të marrë masa teknike-organizative, në mënyrë që të mbrohen sistemet e regjistrimit, mënyrat e transferimit dhe mjetet transmetuese në të cilin gjenden regjistrimet duke i mbrojtur nga akseset e paautorizuara apo aksidentale, ndryshimi, shkatërrimi, humbja ose përpunimi i paautorizuar.

5. Në pikën 4 të dispozitivit të Rekomandimit është lënë si detyrë që Kontrolluesi të përditësojë deklarin në rubrikën 1.1 dhe 1.2 të formularit të “Njoftimit”.

Nga verifikimi i kryer në Regjistrin Elektronik të Subjekteve Kontrolluese të Zyrës së Komisionerit, si dhe nga hetimi administrativ në vend konstatohet se, “Njoftimi” ka mangësi në deklaram, sa i përket rubrikave të formularit, si vijon:

1. Deklarimi në rubrikën 1.1, të formularit të njoftimit “*Të dhënat e subjektit Kontrollues*”;
2. Deklarimi në rubrikën 1.2, të formularit të njoftimit “*Personi i kontaktit ngarkuar nga subjekti*”.

Konstatimet e mësipërme janë në kundërshtim me parashikimet e neneve 21 dhe 22 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, detyrimi për “*Njoftim*” mbi përpunimin e të dhënave personale, sikurse edhe përditësimet e vazhdueshme të gjendjes së përpunimit, sipas parashikimeve të nenit 21 dhe 22 të Ligjit është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen Kontrolluesi, si dhe për realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre që i jep Ligji.

6. Në pikën 5 të dispozitivit të Rekomandimit është lënë si detyrë që Kontrolluesi të rishikojë “*Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, sipas proceseve përpunuese.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së rregullores rezulton se, ajo nuk parashikon në mënyrë të detajuar proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një Rregullore specifike “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vënë në dispozicion Kontrolluesit.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Në seancën dëgjimore të datës 19.11.2024 të organizuar nga Zyra e Komisionerit, është paraqitur përfaqësuesja e Kontrolluesit e cila ka parashtruar qëndrimin e tyre dhe kanë bërë me dije se kanë marrë masa për përmbushjen e detyrimeve në zbatim të Rekomandimit Nr.6, datë 07.05.2024, duke evidentuar njëkohësisht angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të tjera, me paraqitjen e dokumenteve si më poshtë:

- Formular njoftimi;
  - Rregullore e brendshme për sistemin e vëzhgimit me kamera;
  - Autorizim për përfaqësim në seancën dëgjimore;
  - Formular regjistrimi;
  - Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.
- Lidhur me formularin e regjistrimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi në këtë Formular, mbledh të dhëna për prindërit ose persona të tjerë përgjegjës, lidhur me profesionin, vendin e punës, si dhe informacion mbi vendbanimin dhe gjendjen familjare, në kundërshtim kjo me parimin e mjaftueshmërisë, sipas gurmës “c”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se kategoritë e të dhënave të mbledhura/ruajtura, duhet të jenë në përputhje me parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim, si dhe mbajtjen në atë formë që të lejojë identifikimin e subjekteve të të dhënave për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për qëllimin për të cilin ato janë grumbulluar ose përpunuar më tej. Kontrolluesi duhet të aplikojë parimin për përpunimin e sa më pak të dhënave për të realizuar qëllimin.

- Gjithashtu, lidhur me formularin e regjistrimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi në këtë formular nga Kontrolluesi përkundrejt subjekteve të të dhënave nuk është shterues në lidhje me qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit.
- Lidhur me Rregulloren “*Për Mbrojtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale*”, Zyra e Komisionerit vlerëson se është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi

mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, sipas proceseve përpunuese gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të gremës “a”, “b”, “d” dhe “dh” të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II “Përpunimi i të dhënave personale”, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin e mospërmbushjes së detyrimeve të lëna në Rekomandim, të cilat lidhen me përpunimin e ligjshëm të të dhënave, garantimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave, si dhe marrjes së masave të përshtatshme teknike dhe organizative për sigurinë e të dhënave personale.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Në zbatim të neneve 5, 18, 21, 22, 27, 29, 30, 39 (pika 1, gremat “a”, “b” “d” dhe “dh”, si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

### **VENDOSA:**

1. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në Kreun II të Ligjit;
2. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;

3. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 40 000 (dyzet mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit;
4. Dënimin e Kontrolluesit me gjobë në vlerën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 5 të Ligjit, të marrë masa që mbledhja e të dhënave personale nga ana e tij, të kryhet në mënyre të ligjshme, informacioni të grumbullohet vetëm për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe përpunimi i të dhënave të kryhet në përputhje me këto qëllime, duke ju përmbajtur gjithashtu parimit të mjaftueshmërisë së të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim;
6. Kontrolluesi, të marrë masa për zbatimin e detyrimeve, në lidhje me informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
7. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit, të ketë në vëmendje përditësimin e “Njoftimit”, në lidhje me ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave personale, të cilat përpunon;
8. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të marrë masa për përfshirjen në rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi;
9. Në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
  - i. vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikat 6 dhe 7 më sipër;
  - ii. brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e përcaktuara në pikën 5 më sipër;
  - iii. brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 8 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes në dijeni të këtij akti;

10. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;
11. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit;

**12.** Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë 11.12.2024.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**